

TAKIM ME GUVERNATORIN E BANKËS POPULLORE NË LSHPM

LLOGARIA E PAGESËS ME FUNKSIONE BAZË TË PËRSHTATSHME PËR PENSIONISTËT



Më 2 korrik të këtij viti, në ambientet e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë u mbajt prezantimi i llogarisë së re të pagesave me funksione bazë, e përshtatshme për pensionistët, veçanërisht me pensione të ulëta. Pensionistët mund të hapin një llogari pagese me funksione bazë në banka. Llogaria e re e pagesave ofron më shumë përfitime, siç janë kostot e ulëta të mirëmbajtjes, me mundësinë e përdorimit të një grapi relativisht të gjërë shërbimesh pagesash nga bankat, për një tarifë që aktualisht nuk mund të kalojë 38 denarë, që është me rëndësi të madhe për uljen e barrës financiare të pensionistëve. Kjo u theksua në takimin e përfaqësuesve të Bankës Popullore, të udhëhequr nga guvernatorja, Anita Angelovska-Bezhoska dhe zëvendësguvernatorja Nacevska, me kryetaren e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë (LSHPM), Stanka Trajkova dhe përfaqësues të Lidhjes. Në takim, Guvernatorja Angelovska-Bezhoska theksoi rëndësinë e bashkëpunimit më të ngushtë me shoqatat e pensionistëve, me qëllim të mbrojtjes

së tē drejtave të tyre si shfrytëzues të shërbimeve të pagesave dhe informimin e tyre për të rejat dhe lehtësimet që ofron korniza e re ligjore në këtë sferë.

Në kuadër të vizitës në LSHPM, zë-vendësdrejtoresha e Drejtorisë për sisteme të pagesave, Biljana Donovska-Geceva, para përfaqësuesve të Lidhjes bëri një prezantim, gjatë së cilës u referua përkarakteristikat e llogarisë së pagesave dhe funksionet e saj themelore. Ajo theksoi se me ligjin e ri për shërbimet e pagesave dhe sistemet e pagesave, për herë të parë në vendin tonë është futur llogaria e pagesave për të cilën masa e kompensimit është e kufizuar ligjërisht. "Për shërbimet që mbulohen nga llogaria e pagesave me funksione bazë, banka mund të llogarisë dhe të mbledhë një tarifë totale mujore deri në një shumë të arsyeshme të caktuar e cila nuk duhet të jetë më e lartë se 0.1% e mesatares së 12 neto pagesave mujore mesatare të fundit të paguara në vend, sipas Entit Shitetëror të Statistikës (apo aktualisht 38 denarë). Kjo tarifë përfshin mirëmbajtjen e llogarisë së pagesës dhe kartës

debitore, përdorimin online të internetit dhe aplikacionit celular, një numër të pakufizuar transaksionesh pagese për depozitim ose tērheqjen e parave të gatshme direkt në sportelet në ambientet e punës të bankës ose përmes rrjetit të saj të ATM-ve, numrit të pakufizuar të transaksioneve të pagesave me kartela debitore dhe kryerja e së paku pesë transaksioneve të pagesave në të njëjtën bankë", tha Donovska-Geceva.

Duke marrë parasysh grupin e shërbimeve të pagesave që ofron dhe tarifën e ulët mujore, llogaria e pagesës me funksionet bazë është veçanërisht e përshtatshme për pensionistët. Për konsumatorët, të cilët bëjnë pjesë në grupin e përdoruesve të tē drejtave ligjore, llogaria e pagesës me funksionet bazë është falas. Për hapjen e një llogarie pagesë me funksione bazë, në banka paraqitet një kërkesë për hapjen e një llogarie të tillë ose për transformimin e asaj ekzistuese. Në takim u theksua nevoja për ulje të komisioneve nga bankat, deri në vlerën e kostove reale, për tē mbrojtur standardin e pensionistëve. (K.S.A)

SHP ÇAIR



Ekskursion njëditor në Krushevë

Traditën e ekskursioneve dhe vizitave të organizuara në vende të rëndësishme në vendin tonë dëshiron jashtë tij, Shoqata e pensionistëve Çair e vazhdoi edhe këtë vit. Kështu u zhvillua një ekskursion njëditor me përbërje të përzier etnike për pesëdhjetë anëtarë në pension të shoqatës. Në mëngjesin e 27 qershorit, pensionistët nga Çairi shkuan me autobus në një ekskursion njëditor në Krushevë, duke u nisur nga fakti se në këtë mënyrë pensionistët miqësohen, bëjnë miq të rinj, pushojnë dhe njihen me bukuritë e Maqedonisë. Dita e bukur me diell paralajmëroi një udhëtim të këndshëm, i cili u bë edhe më interesant me muzikë, këngë dhe batuta.

Krusheva është një qytet tipik malor, në shpatiet e malit Baba, me mbi 1250 metra mbi nivelin e detit, që është qyteti më i lartë në Gadi-shullin Ballkanik. Pensionistët janë të kënaqur me bukuritë natyrore të këtij etno-qyteti, në të cilin bazohet një pjesë e historisë së Maqedonisë.

Pasi vizituan Meçkin Kamenin, ku u zhvillua një nga betejat më të përgjakshme të Kryengritjes së Ilindenit më 12 gusht 1903, manastirin "Shpërfytyrimi i Shenjtë", varrin e ikonës së popit Toshe Proeski dhe shtëpinë e tij përkujtimore, pensionistët bënë një shëtitje admiruese përreth qytetit duke u mahnitur me arkitekturën e tij autentike. Relacioni ishte i gjatë dhe i vështirë për këtë grupmoshë, por është përtu laudëruar vitaliteti i pensionistëve që me barrën e viteve ecën me lehtësi. Pamja ishte e bukur, ajri malor i pastër, bukuria, ndjenjat zgjohen këtu, e gjithë kjo nuk mund të pëershkruehet, vetëm duhet përfjetuar. Në një miqësi të paharrueshme plot mbresa dhe eksperiencia pozitive, ky ekskursion do të mbahet mend gjatë. (Vasil Paçemski)



SHP TETOVË

DEGA E TEARCËS, SHEMBULL PËR BASHKËJETESË NDËRETNKE

duke i realizuar aktivitetet projektuase në kohë e me cilësi.

Kryetari i degës vendore të pensionistëve të Tearcës, Bilall Amiti, gjatë bisedës së zhvilluar, vlerëson lartë punën organizative të pensionistëve të vendbanimeve që përfshihen në këtë degë. Ai për gazeten "Penzioner Plus" nënvizon se Dega, gjegjësisht Këshilli i saj, në mënyrë të rregullt i organizon dhe zhvillon mbledhjet, në të cilat shqyrtohen dhe miratohen materiale si Raporte, Programe pune, që i harton Shoqata e pensionistëve, e gjithashu edhe iniciativat dhe propozimet që rezultojnë nga vetë anëtarësia e degës, thekson Amiti. Ai veçon edhe bashkëpunimin me veteqeverisjen lokale të Tearcës, tek

udhëheqësia e së cilës kanë hasur në mirëkuptim për mbajtjen e mbledhjeve në ambientet e ndërtës së komunës. Në mungesë të klubit të pensionistëve, ku do të tuboheshim për t'i mbajtur mbledhjet e duhura, tek komuna kemi hasur në mirëkuptim që t'i shfrytëzojmë ambientet e saj, nënvizon Bilall Amiti.

Sipas kryetarit Amiti, në degët e Tearcës ka shumë pensionistë që janë bartës të aktivitetave projektuase. Në këtë rafsh ai veçon angazhimin e pensionistëve si Bajram Jashari (anëtar i Kuvendit dhe Këshillit ekzekutiv të Shoqatës nga kjo dege), Shafi Shafiu, Sreqko Ristovski, Llokman Reani, Daut Mustafi, etj. Shumica e pensionistëve

të degës së Tearcës kanë qenë ish punonjës të kombinatit elektrometalurgjik "Jugohrom", të kombinatit të teknilit "Teteks", të ndërmarrjes së mobilive "Shik-Jellak", të ndërmarrjes tregtare "Interpromet" si dhe punonjës të arsimit.

Si të këtillë, pjesa dërmuese e tyre realizojnë pensione të ulta. Dega në bashkëpunim me Shoqatën e pensionistëve të Tetovës, përpinqet që në forma të ndryshme t'i mbështesë pensionistët me probleme ekonomike e sociale, duke u dhuruar ndihma të njëherëshme në para, vauçerë me vlerë, duke i përfshirë në ekskursione tek të cilat participin shoqata, duke i përfshirë në aktivitete sportive e kulturore e kështu me radhë. Akti-

vistët e degës së pensionistëve në Tearcë, në takimet e zhvilluara me ta, veçojnë bashkëpunimin e shkëlqyer me Shoqatën e pensionistëve të Tetovës dhe drejtuesit e saj. Këta aktivistë vlerësojnë se gjithmonë kanë hasur në mirëkuptim për kërkësat e degës, ndërsa ky bashkëpunim i ndërsjellë, me intensitet të njëjtë do të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke realizuar projekte në të mirë të pensionistëve, siç ishte rasti i paradohshëm i organizimit të aksionit të matjes së sheqerit në gjak, tensionit të gjakut dhe shërbime të tjera të kësaj natyre në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Tetovës.

(M. Murseli)